



**Plani strategjik 2017 - 2019**  
*"Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë"*

- **Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i NJAB**

- *Qëllimi i planit strategjik*

Plani strategjik 2017 - 2019 "Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë", ka si qëllim identifikimin e fushave të veprimit të strukturës së auditimit të brendshëm të Bashkisë Korçë, për periudhën 3 vjeçare.

Ai bazohet në analizën e risqeve të programeve dhe veprimtarive të identifikuara për auditim dhe përcakton mbulimin/frekuencën e auditimit sipas subjekteve që programohen për audit.

Plani strategjik 2017 - 2019 i veprimtarisë së angazhimeve të auditimit të brendshëm është bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut, të hartuar një herë në vit dhe që ka marrë në konsideratë informacionet nga menaxhimi i lartë dhe bordi i drejtorëve.

Gjatë hartimit të planit strategjik 2017 - 2019 janë marrë parasysh angazhimet e pranuar dhe është bazuar në mundësinë e angazhimit për të përmirësuar menaxhimin e risqeve, shtimin e vlerës dhe përmirësimin e veprimtarive të Bashkisë.

Plani strategjik 2017 - 2019 "Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë", është një element i kontrollit për tu siguruar që të gjitha veprimtaritë, programet dhe operacionet e bashkisë/subjekteve në vartësi të saj, mbulohen nga funksioni i AB.

Funksioni i auditimit të brendshëm, është konsultuar dhe ka rënë dakort me menaxhimin lidhur me problemet e kontroleve të brendshme dhe administrimit, ka synuar që të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin e veprimtarive kryesore dhe me risk më të lartë.

Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave 3 vjeçare për auditime. Vlerësimi i nevojave të auditimit do të rishikohet çdo vit, në kohën kur do të hartohet plani vjetor i auditimit për vitin e ardhshëm, duke u siguruar që janë përfshirë të gjitha veprimtaritë e reja dhe ndryshimet e tjera të programeve.

Frekuenca e auditimit është përcaktuar nga drejtore e auditimit të brendshëm të Bashkisë Korçë, duke u bazuar në shkallën e riskut që shoqëron funksionin e auditimit gjatë implementimit të tij dhe në disa raste në gjykimin e drejtimit.

- *Misioni i NJAB*

Auditimi i brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektiv synon të ndihmojë subjektet e audituara të Bashkisë Korçë, të përmbushin objektivat e tyre. Ai bën vlerësime, jep opinione dhe rekomandime objektive :

- për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut
- për funksionimin dhe mjaftueshmërinë e sistemeve.
- për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontroleve
- për përputhjen e veprimtarisë së njësive me kuadrin rregullator

- për funksionimin e elementëve të kontrollit të brendshëm (ambjentin e kontrollit, menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi)
- për ruajtjen e asetëve
- për besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional
- për të siguruar titullarin e subjektit të audituar se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet, efikasitet, sipas planifikimit dhe qëllimit të miratimit në buxhetin e bashkisë.
- për përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve të njësisë

Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshilla dhe informacion lidhur me veprimtaritë që ka vlerësuar. Duke asistuar të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, i jep menaxhimin të lartë vlerësime të operacioneve e veprimeve, këshillime të pavarura, konfidenciale, për përdorimin me efektivitet, efikasitet, ekonomi të burimeve.

- **Organizimi i NJAB dhe kuadri ligjor.**

- *Organizimi i NJAB*

Struktura e AB në Bashkinë Korçë është drejtori. Sipas vendimit të këshillit bashkiak, struktura është miratuar me 1 drejtor dhe me 3 audite por në fakt të punësuar janë 1 drejtor dhe 2 audite. Puna brenda strukturës është organizuar pa përgjegjës grupi, auditimet kryhen gjithmonë nga të 3 auditet e drejtorisë (drejtorja dhe 2 inspektore të larta për auditimin).

Varësia e njësisë së AB është nga kryetari i bashkisë.

- *Kuadri ligjor*

Struktura e AB është organizuar dhe funksionon në zbatim të

- ✓ Ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"
- ✓ Manualit të AB, miratuar me Urdhërin nr.69, dt.29.09.2010 të Ministrisë të Financave.
- ✓ Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- ✓ Ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil".
- ✓ Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSh".
- ✓ Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH".
- ✓ Ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
- ✓ Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
- ✓ Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektoriatin e Ndërtimit".
- ✓ Ligjit nr.8756, datë 26.03.2002 "Për emergjencat civile".
- ✓ Ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit publikë".
- ✓ Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunave", me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"
- ✓ Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë",
- ✓ Ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në RSh", me ndryshimet përkatëse.

- ✓ Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat" dhe rregulloren e nxjerrë për zbatimin e tij.
- ✓ Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme.
- ✓ Rregullorja e Bashkisë Korçë e miratuar me VKBashkiak për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Korçë, si dhe të gjitha rregulloret e ndërmarrjeve dhe institucioneve të vartësisë.

• **Objektivat strategjikë.**

*Objektivi strategjik* i AB është, të nxisë politikat e qeverisjes së mirë, përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të KB në të gjitha subjektet e audituara. Të detajuara objektivat janë :

1. Dhënia e sigurisë objektive, që risqet janë identifikuar dhe vlerësohen e menaxhohen nga strukturat përgjegjëse.
2. Dhënia e sigurisë së arsyeshme se sistemet e kontrollit janë vendosur, funksionojnë me efektivitet në shkallë të përshtatshme brenda subjekteve të audituara.
3. Dhënia e sigurisë së pavarur dhe objektive, dhënia e këshillimeve të cilat shtojnë vlerën, përmirësojnë operacionet dhe ndihmojnë subjektet e audituara të arrijnë objektivat.
4. Planifikimi dhe kryerja e auditimeve të kombinuara (sistemi pajtueshmërisë dhe financiar).
5. Kryerjen e auditimeve sipas kërkesave të menaxhimit.
6. Krijimin e një koncepti të ri për auditimin e brendshëm si funksion i pavarur, si mbështetje për menaxhimin për realizimin me sukses të detyrave të tij.

• **Identifikimi i subjekteve.**

Për periudhën 2017-2019 janë identifikuar 11 subjekte auditimi si vijon :

Bashkia Korçë, Ndërmarrja Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhe, Qendra e artit e kulturës (Biblioteka, Teatri, Qendra Kulturore), Klubi Shumësportësh "Skënderbeu", Klubi Futbollit "Skënderbeu", Njësia e menaxhimit të banesave me qëllim social, Qendra Ditore e Riaftësimi, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit të Antikapatëve, Shtëpia e foshnjës, Tregu i Shitjes me Shumicë fruta-perime sh.a.

• **Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare.**

Sipas subjekteve janë identifikuar fushat si vijon :

**Bashkia** sipas fushave : Të ardhurat, Kontrolli Territori, Prokurimet, Policia Bashkiake, Mbrojtja nga zjarri e shpëtimi, Hartimi dhe implementimi i projekteve dhe turizmit, Planifikimi dhe kontrolli i zhvillimit të territorit, Shërbimi Urban, Shërbimi Pastrimit, Shërbimi i varrezave, Shërbimi i Kujdesit Social, Financa, Drejtoria Juridike, Shërbimi i informimit qytetar, Burimet Njerëzore, Inspektoriati Mbrojtjes së territorit, Shërbimet në njësi administrative e rajone, Shërbimet në sektorin e bujqësisë e pyjeve.

**Nd.&Instituc. Vartësi :** Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (Gjelberimi, Rrugët rurale, Bordi i kullimit), Ndërmarrja Shërbimeve Mbështetëse Arsimit&Çerdhes, Qendra e artit e kulturës (Biblioteka, Teatri, Qendra Kulturore), Klubi Shumësportësh, Klubi Futbollit, Njësia e menaxhimit të banesave me qëllim social, Qendra Ditore, Qendra Rezidenciale, Shtëpia foshnjës.

**Shoqëri anonime :** Tregu Shitjes Shumicë sh.a.

• **Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve.**

Gjithësej janë 11 subjekte për tu audituar (bashkia + 10 ndërmarrje e institucione vartësie). Brënda bashkisë janë identifikuar gjithësej 18 fusha për tu audituar nga të cilat 9 fusha vlerësohen me risk të lartë dhe 9 fusha të tjera me risk të mesëm.

Për 10 ndërmarrjet dhe institucionet e vartësisë 3 prej tyre janë vlerësuar me risk të lartë, 5 institucione janë vlerësuar me risk të mesëm dhe 2 institucione me risk të ulët.

Në të tre vitet e planit strategjik janë parashikuar për tu audituar më parë institucionet dhe fushat me risk të lartë, duke mbajtur parasysh edhe ndryshimet strukturore e fushat e reja që i bashkohen veprimtarisë së bashkisë, në kuadrin e reformës territoriale.

Përmendim fushat e Mbrojtjes nga zjarri e shpëtimi, Shërbimet në sektorin e bujqësisë e pyjeve, Rrugët rurale dhe Bordin e kullimit.

Në vlerësimin e riskut jemi nisur nga rezultatet e auditimeve të mëparshme për subjektet e fushat e parashikuara për auditim. Ndërsa për subjektet e fushat e reja vlerësimi i riskut është bërë përgjithësisht në nivelin e lartë për shkak të njohjes së kufizuar të veprimtarisë së tyre.

Në hartimin e Planit Strategjik të AB kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm :

<i>Rëndësia.</i>	Njësia e AB të shpenzojë më shumë kohë për fushat e reja dhe më me rëndësi për Bashkinë.
<i>Materialiteti.</i>	Për fushat e mëdha të të ardhurave dhe shpenzimeve të harxhohet më shumë kohë auditimi.
<i>Ndryshimi.</i>	Kur një sistem apo fushë ka ndryshuar, risku rritet, prandaj AB të shikojë për këto ndryshime në vitin që janë bërë ndryshimet.
<i>Risku.</i>	Burimet e AB t'i kushtohen fushave ku risku është më i lartë.
<i>Pikpamjet e menaxhimit.</i>	AB të marrë në konsideratë shqetësimet e menaxherëve.
<i>Frekuenca.</i>	Frekuencë më e shpeshtë tek subjektet me risk më të lartë.
<i>Ndikimi i jashtëm.</i>	Monitorimi i strukturës së AB.

• **Kufizimet e Auditimit**

- Vlerësimi i auditimit si njësi inspektimi, nga titullarët e subjekteve e fushave të parashikuara për auditim.
- Ndryshimet e planit të parashikuar për shkak të kërkesave të titullarit për projekte apo detyra të posacme.
- Mungesa e bashkëpunimit reciprok dhe përgjegjshmëria e subjekteve që auditohen.
- Mungesa e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve nga vetë subjektet që auditohen.
- Mungesa e veprimtarive të kontrollit të brendshëm të vendosura nga vetë subjektet që auditohen.
- Mungesa e audituesve të certifikuar.

• **Prioritete**

- Ngritja dhe zhvillimi profesional i audituesve.
- Monitorimi i strukturës së AB, sigurimi i cilësisë së auditimit.
- Monitorimi i sitemit të raportimit të të dhënave për veprimtarinë e AB.
- Zhvillimi i veprimtarisë së AB në pajtueshmëri me Kartën e AB dhe dispozitat ligjore.

- Ofroimi i sigurisë së tillë që veprimtaria e AB të konsiderohet nga strukturat e larta drejtuese, si shtim vlere dhe përmirësim i aktivitetit të subjekteve.

Bashkangjitur me Planin Strategjik janë anekset si më poshtë :

- **Anekset e Planit Strategjik**

- *Pasqyra 1, "Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitet 2017-2019"*, sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të AB të Ministrisë së Financave.
- *Pasqyra 2, "Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar në vitet 2017-2019"*, sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të AB të Ministrisë së Financave.

DREJTORIA E AUDITIMIT BRENDSEHEM BASHKIA KORÇË

Drejtore

Athinulla TREBICKA



Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2017-2019

Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
			I lartë	I mesëm	I ulët
a.	I	2	3	4	5
1	BASHKIA	Të Ardhurat	x		
2	BASHKIA	Kontroll Teritori	x		
3	BASHKIA	Prokurimet	x		
4	BASHKIA	Policia Bashkiake		x	
5	BASHKIA	Mbrojtja nga zjarri e shpëtimi	x		
6	BASHKIA	Hartimi dhe implementimi i projekteve dhe turizmit	x		
7	BASHKIA	Planifikimi dhe kontrolli i zhvillimit të territorit		x	
8	BASHKIA	Shërbimi Urban	x		
9	BASHKIA	Shërbimi Pastrimit		x	
10	BASHKIA	Shërbimi i varrezave		x	
11	BASHKIA	Shërbimi i Kujdesit Social		x	
12	BASHKIA	Financa	x		
13	BASHKIA	Drejtoria Juridike	x		
14	BASHKIA	Shërbimi i informimit qytetar		x	
15	BASHKIA	Burimet Njerëzore	x		
16	BASHKIA	Inspektoriati Mbrojtjes së territorit		x	
17	BASHKIA	Shërbimet në njësi administrative e rajone		x	
18	BASHKIA	Shërbimet në sektorin e bujqësisë e pyjeve		x	
19	ND.Shërbimeve Publike		x		
20	ND.Shërbimeve Mbështetëse Arsimit		x		
21	Qendra e artit e kulturës (B.T.K.)		x		
22	Klubi Shumspportësh "Skënderbeu"			x	
23	Klubi Futbollit "Skënderbeu"			x	
24	njësia e menaxhimit të banesave me qëllim social			x	
25	Qendra Ditore e Rrafshimit			x	x
26	Qendra Zhv.Antikapitë(Rezidenciale)			x	
27	Shtëpia e foshnjës				x
28	Tregu i Shitjes me Shumicë sh.a.			x	

Drejtuessi i NJAB Athinulla Trebicka




Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2017-2019

SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE						
Nr	Viti planifikuar	Niveli i Riskut i planifikuar (V. planifikuar)	Viti i planif.+1	Niveli i Riskut (V. planif.+1)	Viti i planif.+2	Niveli i Riskut (V. planif.+2)
a.	1	2	3	4	5	6
1	BASHKIA - Prokurimet	larte				
2	BASHKIA-Mbrojja nga zjarri e shpëtimi	larte				
3	BASHKIA - Shërbimi i varrezave	mesem				
4	BASHKIA - Inspektoriati Mbrojtjes Territorit	mesem				
5	BASHKIA - Shërbimet në sektorin e bujqësisë e pyjeve	mesem				
6	ND.Shërbimeve Publike	larte				
7	ND.Shërbimeve Mbështetëse Arsimit	larte				
8	Qendra e artit e kulturës (B.T.K.)	larte				
9			BASHKIA - Té Ardhurat	larte		
10			BASHKIA - Kontroll Territori	larte		
11			BASHKIA - Policia Bashkiake	mesem		
12			BASHKIA-Planifikimi dhe kontrolli i zhvillimit të territorit	mesem		
13			BASHKIA-Shërbimi i Kujdesit Social	mesem		
14			BASHKIA-Shërbimi i informimit qytetar	mesem		
15			BASHKIA-Burimet Njerëzore	larte		
16			BASHKIA-Shërbimet në njësi administrative e rajone	mesem		
17					BASHKIA-Hartimi dhe implementimi i projekteve dhe turizmit	larte
18					BASHKIA - Shërbimi Urban	larte
19					BASHKIA - Financa	larte
20					BASHKIA - Drejtoria Juridike	larte
21					Klubi Futbollit "Skënderbeu"	mesem
22					Qendra Ditore e Rialtësimit	ulët
23					Qendra Zhv.Antikapate(Rezidenciale)	mesem
24					Regu i Shitjes me Shumicë sh.a.	mesem
	SHUMA	8		8		8

Drejtuesi i NJAB Athinullaj Trebicka

MIRATOHET  
SOTIRAQ FILO

KRYETARI I BASHKISË



## Plani vjetor i auditimit, 2017

*"Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë"*

- **Zhvillimet aktuale të NJAB.**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të bashkisë Korçë për vitin aktual 2016 ka planifikuar 8 auditime prej të cilave priten të realizohen 5 prej tyre dhe 1 auditim i paplanifikuar. Pritet të realizohen 3 auditime më pak për shkak të problematikës që ka rezultuar nga ish komunat që kaluan në vartësi të bashkisë Korçë. Është realizuar 1 auditim i paplanifikuar që ka lidhje me sistemin e pagesave për detyrimet e energjisë elektrike nga subjektet e bashkisë, sipas kërkesës së kryetarit të bashkisë.

- **Prioritetet e auditimit për vitin 2017.**

- Ngritja dhe zhvillimi profesional i audituesve.
- Monitorimi i strukturës së AB, sigurimi i cilësisë së auditimit.
- Monitorimi i sitemit të raportimit të të dhënave për veprimtarinë e AB.
- Të sigurohet që puna do të kryhet në përputhje me objektivat e paracaktuara.

- **Objektivat kryesorë për vitin 2017.**

Auditimi i brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektiv synon të ndihmojë subjektet e audituara të Bashkisë Korçë, të përmbushin objektivat e tyre. Ai bën vlerësime, jep opinione dhe rekomandime objektive :

- për funksionimin dhe mjaftueshmërinë e sistemeve.
- për përputhjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore.
- për funksionimin e elementëve të kontrollit të brendshëm (ambjentin e kontrollit, menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi)
- për të siguruar titullarin e subjektit të audituar se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet, efikasitet, sipas planifikimit dhe qëllimit të miratimit në buxhetin e bashkisë.

AB ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshilla dhe informacion lidhur me veprimtaritë që ka vlerësuar. Duke asistuar të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre, i jep menaxhimit të lartë vlerësime të operacioneve e veprimeve, këshillime të pavarura, konfidenciale.

Qëllimi i funksionit të auditimit të brendshëm është, të nxisë politikat e qeverisjes së mirë, përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në të gjitha subjektet e audituara. Në mënyrë të detajuar AB ka për qëllim :

1. Dhënien e sigurisë objektive, që sistemet e kontrollit janë vendosur, funksionojnë me efektivitet në shkallë të përshtatshme brenda subjekteve të audituara.
2. Dhënien e sigurisë së pavarur dhe objektive, dhënien e këshillimeve të cilat shtojnë vlerën, përmirësojnë operacionet dhe ndihmojnë subjektet e audituara të arrijnë objektivat.



3. Planifikimin/kryerjen e auditimeve të kombinuara (sistemi pajtueshmërisë dhe financiar).
4. Kryerjen e auditimeve sipas kërkesave të menaxhimit.
5. Krijimin e një koncepti të ri për auditimin e brendshëm si funksion i pavarur, si mbështetje për menaxhimin për realizimin me sukses të detyrave të tij.

- **Programimi i llojit të anagazhimeve.**

Për vitin 2017 janë parashikuar 8 auditime prej të cilave 5 auditime janë parashikuar për 5 fusha të subjektit të Bashkisë dhe 3 auditime janë parashikuar për ndërmarrjet e vartësisë.

Nga këto 8 auditime janë parashikuar 1 auditim përputhshmërie, 2 auditime performance dhe 5 auditime të kombinuara.

Janë parashikuar për vitin 2017 fusha të reja brënda subjektit të bashkisë si dhe ndërmarrjet e vartësisë me risk më të lartë dhe me ndryshime më të shumta në kuadër të reformës territoriale.

- **Planifikimi i kostos për vitin 2017.**

Pjesë e rëndësishme e Planit Vjetor është Planifikimi i kostove të auditimit dhe mbulimi i tyre. Ky proces na ka ndihmuar për të siguruar mbulimin me auditim të përshtatshëm të fushave me risk të lartë në subjektet që auditohen. Duke parashikuar kostot dhe alokimin e burimeve, shkëmbimi i informacionit dhe koordinimit të planeve të auditimit me KLSH ndihmon për mbulimin më të mirë dhe mënjanon mundësinë e dublimit apo të mbivendosjes së punës.

Në përcaktimin e kostove të auditimit , më konkretisht në planifikimin e kohës së punës, krahas kohës së nevojshme për punën audituese janë marrë parasysh edhe faktorët :

- a. Koha për mbikqyrjen – e gjithë puna audituese është subjekt rishikimi nga drejtori për të siguruar cilësinë e punës.
- b. Koha për trajnim – është planifikuar një kohë e caktuar për trajnim për rritjen profesionale të AB.
- c. Koha për ndjekjen e rekomandimeve – është koha për të verifikuar nëse menaxhimi ka vepëruar në kohë për zbatimin e rekomandimeve.
- d. Koha rezervë – parashikohet për çështje të paparashikuara që mund të dalin gjatë vitit.
- e. Koha për menaxhim dhe administrim – e cila parashikon kryerjen e detyrave të veçanta të caktuara nga menaxhimi dhe punë administrative.

Në mënyrë të përmbledhur **kostot e auditimit** sipas elementëve kryesorë paraqiten :

1) Buxheti gjithsej (2+3+4)	3359 mijë lek
2) Paga dhe sigurime shoqërore	2917 mijë lek
3) Shpenzime Udhëtimi & Dieta	370 mijë lek
4) Të tjera	72 mijë lek
5) Numuri i punonjësve	3 punonjës
6) Kosto për person (1/5)	1120 mijë lek/për person

- **Planifikimi i burimeve për vitin 2017.**

*Burimet e planifikuara janë :*

1. Koha maksimale e vlefshme	780 ditë	(52 javë x 5ditë x 3persona)
2. Pushime Vjetore	60	„ (4 javë për person x 3persona)
3. Ditë pushimi (Festa Zyrtare)	33	„ (11 ditë për person x 3persona)
4. Pushime për arsye shëndetësore	15	„ (1 javë për person x 3persona)

5. Angazhime në trajnime	30	„ (10 ditë për person x 3persona)
6. Angazhime në mbledhje/takime	12	„ (1 ditë në çdo tre mujor)
7. Rezerva të Planifikuara	30	„ (10 ditë për person x 3persona)
<b>TOTALI</b>	<b>600 ditë</b>	<b>200 ditë/person</b>

• **Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim.**

Stafi i Drejtorisë së AB i Bashkisë Korçë ka qënë pjesë e trajnimit bazë profesional. Drejtore e drejtorisë ka ndjekur programin e trajnimit dhe certifikimit për nivelin e parë të kualifikimit dhe ka fituar që në vitin 2005, titullin "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik".

Gjithashtu, sipas kriterëve të vendosura në ligjin e AB, drejtuesi i njësisë i është nënshtruar edukimit të përditësuar, trajnimit të vijueshëm e të detyrueshëm, të cilat programohen dhe menaxhohen nga Drejtoria e harmonizimit të AB në Ministrinë së Financave

Gjatë vitit 2016, një nga auditet ka filluar kursin e certifikimit si Auditues i Brendshëm në sektorin publik.

Një analizë e nevojave për trajnim të stafit auditues të bashkisë sipas temave, ju dërgohet në pasqyrën 4 bashkëngjitur materialit.

Bashkëngjitur me Planin Vjetor janë anekset si më poshtë :

• **Anekset e Planit Vjetor**

- *Pasqyra 3 "Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2017"*, sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të AB të Ministrisë së Financave.
- *Pasqyra 4 "Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2017"* sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të AB të Ministrisë së Financave.
- *Pasqyra 5 "Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2017"* sipas përcaktimeve të Drejtorisë së Harmonizimit të AB të Ministrisë së Financave.

DREJTORIA E AUDITIMIT BRENDSEHEM BASHKIA KORÇË

Drejtore


Athinulla TREBICKA



Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2017

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime Gjithsej (4.1+4.2+4.3+4.4+4.5+4.6)	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsulentëve	Grupi i Auditimit (nr.auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5
1	BASHKIA	Prokurimet	1	1						3
2	BASHKIA	Mbrojtja nga zjarri e shpëtimi	1					1		3
3	BASHKIA	Shërbimi i varrezave	1					1		3
4	BASHKIA	Inspektoriati Mbrojtjes se territorit	1		1					3
5	BASHKIA	Shërbimet në sektorin e bujqësisë e pyjeve	1		1					3
6	ND. Shërbimeve Publike		1					1		3
7	ND. Shërbimeve Mbështetëse Arsimit		1					1		3
8	Qendra e artit e kulturës (B.T.K.)		1					1		3
9			0							
10			0							
11			0							
12			0							
13			0							
14			0							
15			0							
16			0							
17			0							
18			0							
19			0							
20			0							
	<b>SHUMA</b>		8	1	2	0	0	0	5	24

Drejtpuesi i NJAB Athinulla Trebicka



**NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË BASHKINE KORÇE**

Pasqyra 5

**Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2017**

BURIMET E PLANIFIKUARA				BUXHETI I PLANIFIKUAR		
Nr	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlogaritja e burimeve	Nr	Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	
1	2	3	4	5	6	
1	Koha maksimale e vlefshme	780	52 javë x 5ditë x 3persona	1	Buxheti Gjithsej	3359
2	Pushime Vjetore	60	4 javë për person	2	Paga dhe Sig.Shoqëtorë	2917
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	33	11 ditë për person	3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	370
4	Pushime për arsye shëndetësore	15	1 javë për person	4	Të tjera	72
5	Angazhime në trajnime	30	10 ditë për person	5	Numri i Punonjësve	3
6	Angazhime në mbledhje/takime	12	1 ditë në çdo muaj	6	Kosto për Person (1/5)	1120
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	30	10 ditë për person			
	<b>TOTALI</b>	600	200 ditë/person			

Drejtuuesi i NJAB Athinulla Prebicka

